



MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS

BALETI KOMBËTAR I KOSOVËS / NACIONALNI BALET KOSOVA / NATIONAL BALLETT OF KOSOVO

Bazuar në nenin 10, pika 2.2 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, Ligjin Nr.02/L-59, për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Rregulloren (QRK) NR.15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS PËR ANGAZHIM NË INSTITUCIONIN E BALETIT KOMBËTAR TË KOSOVËS
BALETI "ARRTHYESI" – MUZIKA NGA P.I.TCHAIKOVSKY

Titulli i punës: (Balerin/ë)

Referenca: 01/2023 - BKK

Balerinë profesionistë: 7 pozita

Balerinë jo profesionistë – 8 pozita (fëmijë nga mosha 9 deri 14 vjeç)

Kategoria funksionale: Krijuesit dhe Performuesit e Kulturës

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Merr pjesë në provat e rregullta ditore, nga dt 06.11.2023 deri në premierën dhe reprizën e parë të shfaqjes "Arrthyesi", me dt 16.12.2023 dhe 17.12.2023.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

Profesionistët e diplomuar në fushën e baletit (për balerinët profesionistë)

Balerinët (fëmijët) të kenë njohuri bazike për baletin klasik

Aftësi për të punuar në grup;

Shkathësi të mira komunikuese dhe gatishmëri për punë me orar fleksibël të punës, në varësi të kërkesave të koreografit;

Procedurat e konkurrimit:

Përzgjedhja e balerinëve bëhet përmes audicionit.

Balerinët (të dyja kategoritë), do të mbajnë klasë baleti në audicion (kohëzgjatja 45 min)

Për datën e audicionit, aplikantët do të njoftohen pas përmbylljes së konkursit.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar sipas kushteve të kontratës.

Akte ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Ligji i Punës, Nr. 03/L-212, Ligji Nr.02/L-59, për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Rregulloren (QRK) NR.15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore, RREGULLOREN (MKRS) NR. 02/2021 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES (MKRS) NR.01/2015 PËR PAGESAT E TË ANGAZHUARVE TJERË NË SHFAQJET E BALETIT KOMBËTAR TË KOSOVËS

Kohëzgjatja e emërimit: Balerinët të cilët pranohen përmes Konkursit Publik, kanë kohëzgjatje të kontratës, për një periudhë të caktuar, 35 ditore.

Data e hapjes dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi është i hapur (10) ditë, nga data 01.11.2023 deri me datë 10.11.2023

Kërkesa për pjesëmarrje në audicion, dërgohet përmes email-it baleti.i.kosoves@gmail.com

Data e fundit e aplikimit është: 10.11.2023 - ora 16:00

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni shkarkohet nga Ueb faqja e MKRS-së dhe dorëzohet në Zyrën e Drejtorit të Baletit Kombëtar të Kosovës, në ndërtesën e Teatrit Kombëtar të Kosovës, Sheshi "Nëna Terezë".

Për informata shtesë kontaktoni në numrat 044689897 dhe 044357016.